

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurës A.S. nga ..., me mbrojtësin B.D. për shkak të veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390.paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 288/18, të datës 26.02.2018, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur në prokurori më dt. 26.02.2018, më dt. 29.05.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

E pandehura A.S. nga babai Xh. dhe nëna R. – D., e lindur më dt. data e lindjes... në ..., jeton në ..., lagja “ ... ” ..., e martuar, nënë e tre fëmijëve, me profesion edukatore në SH.F: “ ... ” e gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, më parë e pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R E

sepse më dt. ... rreth orës 10:24 minuta nga Shkolla Filllore “ ... ” në ..., me dashje dhe me qëllim të fillimit të procedurës ndaj F.D., e pandehura përmes telefonit ... nga zyra e drejtorit të shkollës, ka bërë kallëzim të rremë pranë Qendrës Operative Emergjente në Gjilan nr. ..., gjoja se në rrugën “ ... ” personi me emrin F.D., në shtëpinë e tij, po përdorë substancë narkotike dhe posedon dy granata dore, kështu që me qëllim të zbardhjes së rastit Njësi i Policor “ALFA-8-2” dhe Njësi i Hetimeve, është alarmuar dhe kanë shkuar në vendin për të cilin është raportuar, e kanë kontrolluar të paraqiturin dhe objektet përcjellëse të shtëpisë së tij, kanë intervistuar anëtarët e familjes, dhe aty nuk është gjetur asgjë e dyshuar, e që pas një pune intensive të Policisë së Kosovës / Stacioni Policor në Gjilan – Njësi i Hetimeve Kriminale, të nesërmen më dt. ... rreth orës 13:55 minuta, e pandehura ka deklaruar se nuk e ka parë atë për çka ka lajmëruar më dt. ..., por se këtë e ka bërë për arsye se F.D. i kishte shkaktuar një problem motrës së saj gjatë pushimeve të verës

- me çka ka kryer veprën penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390.paragr.1KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,7, 17, 23,40, 41, 42, 46,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 365, 41 dhe 463 KPPK të pandehurës i shqipton

DËNIM ME GJOBË

I. Të pandehurës it i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 600(gjashtëqind)€ i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse e pandehura nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti ka për t’iu zëvendësuar me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të llogaritet një ditë burgu.

II. E pandehura obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh.

III. Në pajtim me nenin 39 nënparagr.3.1 të Ligjit mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit, e pandehura obligohet që në emër të taksës për kompensim të paguaj shumën prej 30 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën PP.nr.288/2018 të dt. 26.02.2018, kundër të pandehurës A.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390.paragr.1 KPRK, me propozim që e pandehura të shpallet fajtores dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Prokurorja në Prokurorinë Themelore në Gjilan Leonora Shemsiu – Kadriu në seancën e caktuar lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më dt. 26.02.2018, mbeti pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë të lidhur konform ligjit dhe dispozitës së nenit 233 KPPRK, me ç'rast e akuzuara është njoftuar me pasojat dhe natyrën e nënshkrimit të pranimit të fajësisë, andaj, mbeti pranë qëndrimit se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata në tërësi të aprovoj marrëveshjen e përmendur.

Mbrojtësi i të akuzuarës av. B.D. dhe e akuzuara A.S. në tërësi janë pajtuar me propozimin e prokurores së shtetit që marrëveshja të aprovohet, se gjatë arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë e akuzuara me vetëdije ka pranuar fajësinë dhe është pajtuar me këtë, ka garantuar se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin, pasi që në mënyrë të sinqertë ka pranuar fajësinë. E akuzuara është penduar, deri sot nuk është gjykuar, andaj lutë gjykatën që të ketë parasysh këtë fakt dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë përmban të gjitha faktet, propozimin për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, njoftimin e të akuzuarës me të drejtat e saj si dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhënia e deklaratës me shkrim, se e njëjta e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se të gjitha këto i ka pranuar vullnetarisht.

Gjykata konstaton se e akuzuara ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë konform nenit 233 KPPRK dhe e njëjta marrëveshje është në harmoni me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata vërtetoi se e akuzuara ka kryer veprën penale dhe konstatoi se nuk ka përjashtime të parapara me nenin 248. KPPRK.

Gjykata aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të PTH-Departamenti i Përgjithshëm nga njëra anë, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj nga ana tjetër për kryerjen e veprës penale të cekur në aktakuzën PP.nr.288/2018 të dt. 26.02.2018, pasi që për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.

Gjykatësja e vetme gjykuese vlerëson se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurës, pas konsultimeve me mbrojtësin e saj, se i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë. Pranimi i fajësie është i mbështetur në faktet e cekura në aktakuzë, andaj, nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me neni 253 paragr.1 KPPRK.

Gjykata është e bindur se dënimi me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 41 KPPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 KPPRK dhe vendimi mbi kërkesën pronësoro-juridike në bazë të nenit 463. KPPRK.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.219/2018 më dt. 29.05.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajllloviq

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

Përktheu –
Naile Keçmezi

